

*Të nderuar,*

Në mbështetje të neneve 147 dhe 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 36, 37, 39, 134, 135 dhe 137 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, ju bëjmë me dije se me vendimet nr. 2 dhe 3, datë 22.04.2026, kam vendosur shpalljen e dy vendeve vakante për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe shpalljen e një vendi vakant për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e pedagogëve të fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

Në zbatim të pikës 2 të neneve 37 dhe 135 jo më vonë se 7 ditë nga shpallja e vendeve vakante, rektori i institucionit të arsimit të lartë dhe drejtori i Shkollës së Magjistraturës shpallin thirrjet për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga anëtarët e personelit akademik dhe nga pedagogët e Shkollës së Magjistraturës që plotësojnë kriteret.

Referuar pikës 5 të neneve 37 dhe 135, mosshpallja e thirrjes në afatin ligjor përbën shkelje disiplinore për rektorin e institucionit të arsimit të lartë dhe drejtorin e Shkollës së Magjistraturës.

Po në zbatim të neneve 40 dhe 138 të këtij ligji, duhet të kryhet nga ana juaj verifikimi i plotë i përmbushjes së kriterëve ligjore nga kandidatët. Mosverifikimi i saktë i këtyre kushteve përbën shkelje disiplinore për anëtarët e dekanatit të fakultetit të Drejtësisë.

Njoftimi i vakancave është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit:

<https://www.parlament.al/lajme/8d022570-f01d-499d-afbe-f99a49a28f01>  
<https://www.parlament.al/lajme/c5895312-5f01-4013-b6bc-ace606e3b329>

Pjesë e njoftimit të publikuar janë edhe dokumentet si më poshtë:

---

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr.4 Tiranë-Shqipëri  
<http://www.parlament.al>

Telefon: 00355 4 22 78 261  
e-mail: [genci.gjoncaj@parlament.al](mailto:genci.gjoncaj@parlament.al)

- Vendimet e Sekretarit të Përgjithshëm;
- Formulari i vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- Formulari i vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- Formulari i vetëdeklarimit të konfliktit të interesit;
- Formulari i vetëdeklarimit të kalimit me sukses të procesit të rivlerësimit;
- Formulari i vetëdeklarimit për moskualifikimin e mëparshëm për shkak të verifikimit të pasurisë dhe figurës sipas legjislacionit në fuqi.

Duke vlerësuar rëndësinë e këtij procesi për funksionimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, kërkohet që brenda datës 1 maj të na përcillni shpalljen e thirrjes nga ana juaj, si dhe të angazhoheni në ndjekjen e procedurës me përparësi dhe rigorozytet të plotë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Genci GJONCAJ**

